



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERET PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 17.7.2019

Lënda: Parashtrime përfundimtare të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 17.7.2019, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 46, datë 24.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Xhezair Zaganjori, magjistrat/gjyqtar, Kryetar i Gjykatës së Lartë

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të ankimit të Komisionerit Publik, ndaj vendimit nr. 46/2018, të Komisionit për subjektin e rivlerësimit z. Xhezair Zaganjori, të gjitha shkaqet e këtij ankimi mbeten për t’u vlerësuar nga ana e Kolegjit.

I. Për sa i takon shkaqeve të ankimit që kanë të bëjnë me interpretimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se dy elemente janë shtuar nga koha e depozitimit të ankimit deri në seancën e sotme.

E para është jurisprudenca e krijuar nga trupa të ndryshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ku kanë gjetur trajtim dhe interpretim gjyqësor çështjet thelbësore, që lidhen me konceptet kushtetuese dhe ligjore të rivlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

E dyta, sikundër u parashtrua nga subjekti i rivlerësimit, është botimi i një manuali nga një grup autorësh shqiptarë, ku pasqyrohen interpretimet përkatëse për përmbajtjen e shtesave dhe ndryshimeve të një pjesë të tekstit të Kushtetutës dhe aneksit të saj.

Komisioneri Publik i kërkon këtij trupi, që bazuar në shkaqet e ankimit, të mbajë të njëjtin qëndrim që është mbajtur në vijimësi tashmë nga ana e Kolegjit, në interpretimin e çështjeve, që kanë të bëjnë me zbatimin e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016.

Komisioneri Publik vlerëson se interpretimi i Kolegjit për koncepte të tillë, si: (a) burimi i ligjshëm i pasurisë; (b) të ardhurat e ligjshme; (c) raporti i deklaratës Vetting me deklaratimet vjetore ndër vite; (d) shkaqet e shkarkimit për deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm; është pothuajse

ezaurues në argumentimin ligjor të vendimeve: (i) nr. 4/2018; (ii) nr. 6/2018; (iii) nr. 7/2018; (iv) nr. 9/018; (v) nr.12/2018; (vi) nr. 1/2019; (vii) nr. 5/2019; (viii) nr. 6/2019; (ix) nr. 7/2019; (x) nr. 8/2019; (xi) nr. 9/2019 etj., vendime këto që janë marrë nga trupa gjykues të ndryshëm të Kolegjit.

II. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori, Komisioneri Publik çmon të parashtrorë edhe njëherë se për të gjitha shkaqet e ankimit, Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit.

Edhe gjatë këtij gjykimi në Kolegj, në seancat e datës 25.6.2019 dhe 10.7.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur akte të tjera, në cilësinë e provës, të cilat u pranuan dhe u administruan nga ky trup.

Komisioneri Publik ka parashtruar qëndrimin e tij në lidhje me shkaqet e ankimit dhe me këto akte të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, në seancat e datave 25.6.2019 dhe 10.7.2019.

Në të tilla kushte, Komisioneri Publik ripërsërit se përmbajtja e këtyre akteve që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, nuk është e tillë që lejon arritjen e konkluzioneve të kundërta nga ato që Komisioneri Publik pretendon në shkaqet e ankimit, si në lidhje me pasaktësinë e vazhduar ndër vite, ashtu edhe, për çfarë është më e rëndësishme, për pamjaftueshmërinë e këtyre deklarimeve të subjektit të rivlerësimit.

E gjejmë me vend të nënvizojmë se, edhe pas paraqitjes së akteve të tjera gjatë këtij gjykimi, sikundër është pretenduar edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, të krijuar nga të ardhura të ligjshme, duke mos plotësuar kështu kërkesat e nenit D të aneksit të Kushtetutës.

Edhe pas hetimit të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik nga ky trup gjykues, qëndrimet e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të detyrimit për të provuar të kundërtën, mbeten më së shumti në nivel deklarativ.

Duke u qëndruar të gjitha argumenteve që janë dhënë në ankim, parashtrimet e datës 25.6.2019 dhe 10.7.2019, në mënyrë të përmbledhur, Komisioneri Publik ripërsërit vlerësimin se për:

A. Katër pasuritë me adresë rruga “***.***.***”, Tiranë:

- (i) apartament me sipërfaqe 296 m²; 100% pronar së bashku me bashkëshorten;
- (ii) bodrum me sipërfaqe 260 m², 2/8 pjesë;
- (iii) bibliotekë me sipërfaqe 281 m², 2/8 pjesë;
- (iv) zyrë me sipërfaqe 57 m², 2/8 pjesë;

në referencë të nenit D, pikat 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vlerën e deklaruar në D-Vett. dhe DV-2003; (ii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për vlerat e deklaruara; (iii) ka mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive në vlerën 10,700,000.00 lekë.

Edhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, pas paraqitjes së akteve të tjera, qëndrimet e subjektit të rivlerësimit mbeten të nivelit deklarativ.

Nënvizojmë se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë, akt apo argumentoi ndonjë rrethanë të re juridike në lidhje me: (i) vlerën e paguar për ndërtimin e godinës; (ii) subjektet që kanë paguar për ndërtimin e godinës; (iii) mënyrën e pagesës së vlerës së punimeve; (iv) preventivë, fatura, situacione apo çdo lloj akti tjetër për të vërtetuar deklaratimet për sa i takon: *a) shumës totale të investimit; b) kohës së kryerjes së tij dhe për rrjedhojë c) aftësisë financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme këtë pasuri të deklaruar nga ana e tij, në kohën e krijimit të saj.*

Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, edhe gjatë hetimit të çështjes nga ky trup gjykues, subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion ligjor justifikues (i) për të provuar pagimin e detyrimeve tatimore për periudhën 1997-1998, për të ardhurën e realizuar nga qiraja, e cila deklarohet pjesërisht si burim krijimi i pasurive në fjalë. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokument edhe në lidhje me mënyrën e transferimit të pjesës takuese së kësaj të ardhure nga z. ****.**** te bashkëshortët Zaganjori.

Për sa i takon (ii) të ardhurave nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, që kanë shërbyer për të pretenduar krijimin e kursimit të deklaruar deri në mesin e vitit 1996, bazuar në aktet e tjera të paraqitura për herë të parë në këtë gjykim (vërtetimet e pagave të MEPJ dhe ISSH), ato janë në vlerën 3.860.090 lekë (të llogaritura të ardhurat janar 1993 - qershor 1996). Shuma e deklaruar e kursyer, në vlerën 2.5 milionë lekë, e dërguar për të investuar në pasuritë e analizuara më sipër, e cila mbetet në nivel deklarativ, përbën rreth 66% të totalit të të ardhurave të realizuara, raport ky relativisht i lartë kursimi. Po ashtu mbetet e paprovuar mënyra e dërgimit të tyre në Shqipëri, referuar kërkesave të udhëzimit nr. 4095/2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

Në të njëjtin nivel deklarativ, edhe pas këtij gjykimi, mbeten edhe (iii) të ardhurat e pretenduara si të kursyera nga një bursë e përfituar prej subjektit të rivlerësimit, në institutin ****.****, Gjermani. Përpos qëndrimit të Kolegjit në vendimin nr. 9/2018, për natyrën e të ardhurave nga bursa, nënvizojmë se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti edhe gjatë këtij gjykimi ndonjë dokumentacion/provë mbi shpenzimet e jetesës për kohën, nivelin e kursimeve të realizuara nga këto të ardhura apo mënyrën e depozitimit të këtyre kursimeve në sistemin bankar (duke qenë se pagesa në formë burse kalonte nëpërmjet sistemit bankar të RFGj-së).

B. Të ardhurat nga qiraja e tri pasurive: (i) bodrum; (ii) bibliotekë; (iii) zyrë

Në referencë të nenit D, pikat 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e ligjshme nga qiratë, për shumën totale prej rreth 8,4 milionë lekë.

Për të ardhurat nga kontrata me qiramarrës *“***.***.***”*, referuar nenit D, pikat 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti ndonjë provë/dokumentacion për të provuar se këto ardhura duhen konsideruar si të ardhura të ligjshme, për periudhën 1997-1998 (trajtuar më sipër në burimin e pasurive, me adresë: rruga *“***.***.***”*), si dhe për periudhën janar 1999 - dhjetor 2005. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, përpos deklaratës noteriale të 8 bashkëpronarëve, nuk paraqiti asnjë akt/provë tjetër (mandate të thjeshta/bankare), në lidhje me vërtetimin e transferimit të të ardhurave të përfituara nga kjo qira, nga znj. ****.**** te subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij.

Referuar detyrimit për të vërtetuar pagesën së detyrimeve tatimore, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për shlyerjen e këtyre detyrimeve për periudhën në fjalë, janë disa

mandate bankare me përshkrimin “*tatim mbi qiranë, familja ****”, paguar nga llogaria e shoqërisë “***.***” sh.p.k. Komisioneri Publik ripërsërit se në shoqërinë “***.***” sh.p.k., znj.***.*** nuk paraqitet në ndonjë cilësi si administratore/ortake/përfaqësuese ligjore, fakt që mund të çonte në hamendësimin se nga llogaria e një subjekti tregtar, me rregulla të posaçme ligjore për administrimin e likuiditeteve, znj.***.*** të kishte kryer pagesa private.

Në këto rrethana, të ardhurat nga qiraja për të gjithë periudhën e pretenduar nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, pasi: **(i)** subjekti i rivlerësimit nuk rezulton me titull pronësie për objektin e dhënë me qira (periudha 1997 - 2001), **(ii)** nuk rezulton palë kontraktuese në kontratën e qirasë dhe **(iii)** nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues shlyerjen e detyrime tatimore për të ardhurën totale të deklaruar, si e ardhur nga pagesa e qirasë prej “***.***.***”.

Edhe akti i hartuar nga ekspertja kontabël, znj. ***.***, paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 10.7.2019, nuk jep përgjigje bazuar në ligj, për asnjë prej shkaqeve të ankimit për këtë pasuri të pretenduar nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke mbetur në kufijtë e supozimeve.

Për sa i takon të ardhurave të krijuara nga marrëdhënia e qiramarrjes me shoqërinë “***.***” sh.p.k., Komisioneri Publik nënvizon se nga verifikimi i akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 10.7.2019, ekziston mandati i një pagese të datës ***-jan-05 (me numër reference ***), ku rezulton se përshkrimi i veprimit të kryer është: “*tatim mbi qira, ***.*** dhe ***.***, 6-mujori i dytë i vitit 2004 (600\$)*”. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik nuk i rezulton që për këtë periudhë subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar të ardhura nga qiraja nga kjo shoqëri apo të jetë depozituar kontratë qiraje. Ky fakt është për t’u vlerësuar edhe në kuadër të deklarimeve të subjektit gjatë seancës së datës 25.6.2019, faqe 11 e procesverbalit gjyqësor., kur pranon se bodrumi, pra një pasuri e ndryshme nga ajo e dhënë më qira për “***.***.***”, “*...shfrytëzohej nga shoqëri private, domethënë si magazinë në periudha të caktuara në të njëjtën godinë*”.

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, për të ardhurat e përfituara nga qiraja e paguar prej subjekteve “***.***.***”, “***.***” sh.p.k., qendra “***.***”, provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, referuar nenit D, pikat 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës nuk provojnë burimin e ligjshëm dhe ligjshmërinë e tyre.

C. Apartament me sipërfaqe 81 m², ***, Plazh, Durrës

Në referencë të nenit D, pikat 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për krijimin pasurisë apartament në ***, Plazh, Durrës, pasi nuk provohet tërheqja e shumës prej 16,000 USD nga llogaria bankare, sipas deklarimeve të vetë subjektit (DV 2006 dhe shpjegime gjatë hetimit administrativ të Komisionit, datë ***.3.2018).

Për këtë pasuri, referuar akteve të tjera të paraqitura gjatë hetimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti prova të plota në lidhje me vërtetimin e burimit të ligjshëm dhe ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga bashkëshortja e tij, znj. ***.***.

Ndërkohë, në lidhje me provueshmërinë e deklarimeve të vetë subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, nuk u paraqit ndonjë provë të re, për të provuar se mbyllja e llogarisë prej 16.000 USD, në një nga bankat e nivelit të dytë, të ishte përdorur për krijimin e pasurisë.

D. Edhe për shkaqet e ankimit që lidhen me: **(i)** shpenzimet e dy djemve të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht në Mbretërinë e Bashkuara dhe RFGj, si dhe **(ii)** diferencat negative për vitet 2011, 2012, 2014, Komisioneri Publik u qëndron shkaqeve të ankimit, si dhe parashtrimeve të datës 10.7.2019, para këtij trupi gjykues, duke vlerësuar se, referuar nenit D, pikat 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

III. Në përfundim të këtyre parashtrimeve, Komisioneri Publik çmon se:

- Në interpretim të pikave 3 dhe 5, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33, pikës 3 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë;

- Bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7 të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 46, datë 24.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori, magjistrat/gjyqtar, Kryetar i Gjykatës së Lartë.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA